

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje paisje mobilim për shkollën e biçikletave”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

3939000-1 Mobilime te ndryshme

39120000-9 Tavolina, dollapë, tavolina pune dhe rafte librash

39150000-8 Mobilje dhe pajisje të ndryshme

39299300-7 Pasqyra qelqi

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **5.833.300 (pesëmilion e tetëqind e tridhjetë e tremijë e treqind) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, ”Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren: 116.666 (njëqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave

citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. 3. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 9001-2015** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

2.1.2 Shoqëria duhet të paraqesë **Certifikatë ISO 14001 (e vlefshme)** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit mjedisor, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

2.1.3 Shoqëria duhet të paraqesë **Certifikatë ISO 45001 (e vlefshme)** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 (ose ekuivalente) Certifikate e menaxhimit të cilësisë

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin pajisjet e mobilimit për shkollën e bicikletave në të cilën do të ketë pjesëmarrje të fëmijëve të moshave të ndryshme si dhe nisur nga kohëzgjatja e konsiderueshme që përdoren këto pajisje, me qëllim furnizimin me pajisje sa më cilësore vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

ISO 14001(ose ekuivalente) -Certifikate për menaxhimin e sistemit mjedisor

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin edhe furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve në ambientet e shkollës për të minimizuar ndikimin në mjedis gjatë procesit të punës është vlerësuar që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

ISO 45001(ose ekuivalente) - Certificate për menaxhimin e sistemit të sigurisë dhe shëndetit

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin një sërë procesesh të cilët kërkojnë cilësi dhe punonjës të kualifikuar vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

2.1.4 Operatori ekonomik, për artikujt e kërkuar si më poshtë duhet të paraqesë certifikatat e produktit:

- Tavoline pune : EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, e njëvlefshme ose e përditësuar
- Dollap SSH EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e njëvlefshme ose e përditësuar
- Karrige rrotulluese (zyre): SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 ,e njëvlefshme ose e përditësuar
- Karrige druri EN 1728:2012; EN 12520:2015; EN 1022:2018

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme. Certifikatat e mesiperme duhet të jene origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e mesiperme duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet kur oferta dorëzohet nga një BOE, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kërkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Tavolinë Pune: EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, standart qe specifikon permasat qe duhet te plotesoje produkti.

EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, ky standard evropian specifikon kërkesat e sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë në tavolinat e punës.

Kërkimi dhe zbatimi i standardit **EN 527-1:2011** është i rëndësishëm për keto arsye si me poshte:

Ergonomia: Siguron që tavolinat e punës të jenë të dizajnuara për të përmbushur nevojat ergonomike të përdoruesve, duke reduktuar rrezikun e lëndimeve dhe problemeve shëndetësore të lidhura me punën.

Komoditeti: Ndhmon në krijimin e një mjedisi pune më të rehatshëm dhe produktiv, duke siguruar që tavolinat të jenë të përshtatshme për përdoruesit në pozicione të ndryshme pune.

Siguria: Siguron që tavolinat të jenë të qëndrueshme dhe të sigurta për përdorim, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve në vendin e punës.

Përputhshmëria: Ndhmon kompanitë të përmbushin kërkesat ligjore dhe rregullative, duke shmangur gjobat dhe problemet e tjera ligjore.

Kualiteti: Siguron që produktet të jenë të një cilësie të lartë dhe të përmbushin pritshmëritë e përdoruesve.

Dollap për klasat e studimit SSH EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, Standart qe nenkupton qe produkti dollap i eshte nenshtuar testeve qe kane te bejne me ushtrimin e forces dhe peshave te ndryshme qe mund te jene te pranishme gjate funksionimit normal te dollapit. Gjithashtu testeve u nenshtrohen edhe pjeset perberese te dollapit. Nje certifikate te tille nenkupton qe dollapi ne teresine e tij ploteson kerkesat e fortesise, rezistences dhe qendrueshmerise.

Kërkimi dhe zbatimi i standardeve si SSH EN 14073-3:2004 dhe SSH EN 14074:2004 është shumë i rëndësishëm për keto arsye si me poshte:

Siguria: Këto standarde sigurojnë që mobiljet të jenë të qëndrueshme dhe të sigurta për përdorim, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve.

Cilësia: Zbatimi i këtyre standardeve ndihmon në garantimin e cilësisë së produkteve, duke siguruar që ato të përmbushin kërkesat e nevojshme për forcë dhe qëndrueshmëri.

Përputhshmëria: Për shumë tregje dhe industri, përputhshmëria me standardet ndërkombëtare është një kërkesë e domosdoshme për të hyrë në treg dhe për të fituar besimin e klientëve.

Karrige rrotulluese SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe perdoret per te percaktuar kerkesat ne lidhje me dimensionet qe duhet te kete nje karrige per perdorim te zakonshem ne menyre qe te sigurohet nje qendrim i pershtatshem per te punuar dhe gjithashtu pershkruan edhe metodat e testimeve te kryera per percaktimin e tyre. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti i prodhuar respekton keto dimensione.

SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe specifikon kerkesat qe duhet te plotesojne keto karrige per sa i perket sigurise, forces dhe qendrueshmerise per nje perdorim rreth 8 ore ne dite dhe per nje person qe peshon deri ne 110 kg. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti eshte i sigurte per nje perdorim te tille.

Keto standarte shoqerohen bashke. Nje certifikate e tille nenkupton qe mobilja e prodhuar i ploteson keto standarte.

Kërkimi i standardeve si SSH EN 1335-1:2021 dhe SSH EN 1335-2:2018 është shumë i rëndësishëm. Këto standarde sigurojnë që karriget të jenë të sigurta, të qëndrueshme dhe të rehatshme për përdoruesit.

Ja disa arsye pse është i rëndësishëm:

Siguria: Standardet përcaktojnë kërkesat për sigurinë e karrigeve, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve.

Komoditeti: Dimensionet dhe dizajni i përcaktuar nga standardet ndihmojnë në sigurimin e një pozicioni të rehatshëm për përdoruesit. **Qëndrueshmëria:** Standardet sigurojnë që karriget të jenë të qëndrueshme dhe të rezistojnë përdorimit të përditshëm. **Përputhshmëria:** Ndjekja e standardeve ndihmon në përputhjen me rregulloret dhe kërkesat ligjore.

Karrige druri EN 1728:2012; EN 12520:2015; EN 1022:2018 standart që përcakton kriteret dhe metodat e testimit për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e tyre. Testet përfshijnë ngarkesa statike dhe dinamike për të siguruar që karriget përmbushin kërkesat e sigurisë dhe performancës.

Disa nga aspektet e rëndësishme që mbulon ky standard për karriget e drurit janë:

Siguria: Këto standarde sigurojnë që karriget dhe tavolinat të jenë të sigurta për përdorim në mjediset arsimore, duke minimizuar rrezikun e lëndimeve.

Ngarkesat dhe forcimi: Testet për të vlerësuar se si karriget përballojnë ngarkesat e zakonshme gjatë përdorimit.

Qëndrueshmëria: Vlerësimi i stabilitetit të karrigeve për të siguruar që ato nuk rrëzohen lehtë gjatë përdorimit.

Materialet: Përcaktimi i cilësisë së drurit dhe mënyrës së ndërtimit që ndikon në qëndrueshmërinë.

Ky standard ndihmon prodhuesit të krijojnë karrige që janë të sigurta dhe të besueshme për konsumatorët.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro sa 40% e vlerës së fondit limit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim. Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedura e Hapur e thjeshtuar-Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomik-financiare", dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomik-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit

2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndërsa kërkesa për shoqërimin me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ”c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të

dhënave të QKB-së.Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 . Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: 1.166.660 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) Kur furnizimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- c) **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.
- d) Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **10 (dhjetë) punonjës** për periudhën e **tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave**.Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e **tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave**.

b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nga ana e AK është kërkuar një numer punonjesh prej 10 personash, sepse kontrata është komplekse, me shume artikuj ku kerkohen punonjes te specializuar ne procese specifike te realizimit të objektit të prokurimit. Shume artikuj jane prodhim sipas permasave te percaktuara ne planet perkatese te mobilimit qe kerkon precision, cilesi dhe shpejtesi ne te njejten kohe. Te gjithë artikujt jane parashikuar te jene Furnizim Vendorsje, pra kemi te perfshire edhe procesin e montimit qe kerkon punonjes te tjere me mobilimin e disa ambienteve dhe procese te ndryshme pune.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës/bashkimi i operatorëve duhet të kenë në stafin e tyre të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme CV, diplomë përkatëse si dhe të rezultojë në listpagesa për 3 muajt e fundit të deklaruar, si më poshtë

- 1 (një) inxhinier druri
- 1 (një) arkitekt

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 40, pika 5, (i ndryshuar). Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën....”*

Sa më sipër përcaktuar në legjislacionin për prokurimin publik autoriteti kontraktor referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar ka kërkuar staf të kualifikuar me qëllim garantimin e cilësisë së realizimit të kontratës. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve duke garantuar Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i kualifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin me cilësi dhe në kohë të kontratës në tërësi.

Bazuar në objektin e prokurimit, volumin kërkesa prej të paktën 1 (një) inxhinier druri është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me natyrën e kontratës. Prania e inxhinierit të sipërcituar, i jep siguri AK se Operatorit Ekonomik ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës.

Objekti i procedurës së prokurimit “Blerje pajisje mobilim për shkollën e bicikletave” përfshin në vetvete edhe procesin e furnizimit dhe vendosjes së mallrave objekt prokurimi sipas një projekti të përcaktuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor pra malli duhet të përshtatet me vendet ku do të vendosen/ montohen, cka ben të nevojshme dhe prezencën e një arkitekti gjatë realizimit të procesit të montimit. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Këto kritere janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punës, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga

legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 2 (dy) mjete transporti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mallrash. Mjeti i transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

Pronësia e mjeteve të mësipërme vërtetohet:

- Mjetet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi)
- Mjetet me qira të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit
- Për mjetet e transportit duhet të paraqiten edhe dokumentet që vërtetojnë regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore)

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar specifikimeve të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë vend-dorezimit të tyre në destinacionin përkatës, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

Jane kërkuar dy kamion të përshtatshëm për transport mallrash për të vërtetuar që ofertuesit pjesëmarrës kanë automjete të nevojshme për transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën, reputacionin dhe besueshmërinë duke qenë se kontrata është komplekse me shumë artikuj të cilat duhet të transportohen dhe të bëhet furnizim vendosja e tyre sipas shkollave të përcaktuara

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e përcaktuara në planin e shpërndarjes. Për ngjyrat e mobiljeve, duhet të kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

Për ngjyrat e mobiljeve duhet të kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter vendoset në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet pasi mallrat objekt prokurimi duhet të transportohen dhe montohen në të gjithë adresat e përcaktuara në plan shpërndarje.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit të artikujve), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre, për paisjet që kanë defekte nga prodhimi.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

2.3.8 Në rastin kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve/ artikujve të mobilerise, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Autorizim Distributori, për pajisjet e ofertuara.

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, eëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.13 Operatori ekonomik të paraqesë në ditën dhe orën e hapjes së procedurës operatori/bashkimi i operatoreve ekonomike duhet të paraqesin mostrat si me poshte të cilat duhet të jenë në përputhje të plote me specifikimet teknike të kërkuara në DST:

- 1 Nr.1 Karrige me 1 krah tavoline (material laminat & dru lisi)
- 2 Nr.22 Tavolina 120x120x75 cm
- 3 Nr.50 Tavolinë leximi me d=60cm dhe h=50cm

Mosparaqitja e mostrave në ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike sipas DST, përben kusht skualifikues.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen qe ti sherbejne AK-se sipas referimeve te VKM Nr 285 date 19.05.2021 neni 40 paragrafi 6 i te cilit percakton: Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastine procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.

Në lidhje më afatin e lëvrimin të mallit nga ana specialistit të fushës u vlerësua se nisur nga volumi i kontratës, proceset që do kryhen (transport, furnizim vendosje), afati i lëvrimin prej 2 (dy) muajsh nga nënshkrimi i kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj"**.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur me urdher Nr 243, Nr.2029/1, datë 30.09.2024